UNIVERSITETI I TIRANËS

FAKULTETI I DREJTËSISË

DEPARTAMENTI I TË DREJTËS PENALE

KONKURS MBI PUNËT KËRKIMORE

JSTOR

FUSHA E APLIKIMIT: KRIMINOLOGJI

"TRAJTIMI I ROLIT TË VIKTIMËS NË KRIM SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR"

Punoi: MSc. Kristina XHAFAJ (DODI)

Master Ekzekutiv Në Kriminologji, Viti i Dytë

TIRANË, 2021

Hyrje

Roli i viktimës në kryerjen e një krimi është një rol pasiv, i cili vuan vetëm pasojat e veprës penale. Termi "viktimë" përkufizohet nga disa instrumenta ndërkombëtarë dhe nënkupton çdo person fizik që ka pësuar dëm, duke përfshirë dëmtim fizik, mendor, emocional ose ekonomik që është shkaktuar drejtpërdrejt nga një vepër penale si dhe anëtarët e familjes së një personi, vdekja e të cilit është shkaktuar drejtpërdrejt nga një vepër penale.

Viktima përveç rolit të saj tradicional në kryerjen e një veprë penale, në disa raste bëhet edhe shkak për ndërmarrjen e veprimeve kriminale ndaj saj.

Në këtë punim, do ti kushtohet një vëmendje e veçantë mbrojtjes së nevojshme dhe kapërcimit të kufijve të saj. Për shkak të rrethanave të ngjarjes dhe mungesës së qetësisë për të menduar drejtë në momentin e një sulmi, viktima e një veprë penale mund të kthehet në autor dhe të përgjigjet para ligjit si çdo autorë tjetër që ka ndërmarrë veprime kriminale.

Disa viktima bëhen shkak për kryerjen e veprës penale ndaj tyre vetëm për shkak të cilësive që ato mbartin. Sa aktiv është roli i këtyre personave të kryerjen e një krimi dhe a janë keta persona vetëm viktima të veprave penale apo më kanë qenë më parë edhe autorë të tyre?

Përkufizimi i termit "viktimë" është bërë që prej vitit 1985 me Deklaratën e Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit të Pushtetit. Sipas kësaj deklarate[1] "*Viktima nënkupton personat që, individualisht ose kolektivisht, kanë pësuar dëm, përfshirë dëmtime fizike ose mendore, vuajtje emocionale, humbje ekonomike ose cënim të të drejtave të tyre themelore, përmes veprimeve ose mosveprimeve që janë në kundërshtim me ligjet penale që funksionojnë brenda Anëtarëve Shtetet, përfshirë ato ligje që parashikojnë shpërdorimin kriminal të pushtetit.*" Një tjetër instrument ndërkombëtar, më i përditësuar është Direktiva 2012/29 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 25 tetorit 2012 "Vendosja e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit". Sipas saj "*Viktimë do të thotë një person fizik i cili ka pësuar dëm, duke përfshirë dëmtim fizik, mendor ose emocional ose humbje ekonomike që është shkaktuar drejtpërdrejt nga një vepër penale si dhe anëtarët e familjes së një personi, vdekja e të cilit është shkaktuar drejtpërdrejt nga një vepër penale dhe që kanë pësuar dëm si rezultat i vdekjes së atij personi*".

Edhe pse ky përkufizim është bërë shumë vite më parë, legjislacioni penal shqiptar e ka interguar këtë term në nenet e tij shumë vonë. Tashmë, legjislacioni penal shqiptar është harmonizuar me instrumentat ndërkombëtarë duke përdorur këtë term për çdo person që pësON një dëm nga vepra penale.

Nisur nga përkufizimi që bën Direktiva 2012/29 viktimë konsiderohet jo vetëm personi fizik ndaj të cilit drejtohen veprimet kriminale, por kur ky person ka humbur jetën, viktimë konsiderohen dhe familjarët e tij. Kodi i Procedurës Penale(KPP) në shumë nene[2] të tij, barazon viktimën me trashëgimtarët e saj. Gjithashtu, siç përcakton dhe Direktiva 2012/29, në rastin e vdekjes së

[1] Miratuar nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 40/34 të 29 Nëntorit 1985, pika 1.

[2] Ligji Nr.7905, datë 21.03.1995 ***"Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë"*** i ndryshuar, nenin 58 pika 4, nenin 61, 291 pika 2, nenin 327 pika 2, nenin 328 pika 2, nenin 329/a pika 4, nenin 329/b pika 1, nenin 329/c pika 1, nenin 329/ç, nenin 332/a pika 1, nenin 332/gj pika 2, nenin 405 pika 1, nenin 406/d pika 4, nenin 451.

viktimës të veprës penale, anëtarët e familjes[3] së saj konsiderohen viktima kur kanë pësuar një dëm.

Në çdo krim të kryer ka dy viktima: viktima në kuptimin e ngushtë që vuan dëmin e shkaktuar ndaj personalitetit ose pronës së saj dhe shoqëria e cila vuan si pasojë e shkeljes së rregullave të vendosura për rregullimin e funksionimit normal të saj.[4] Sipas një studimi, këto viktima janë quajtur ndryshe viktimat primare dhe sekondare.[5] Teorikisht, pasojat e kryerjes së një vepre penale i vuan vetëm viktima dhe anëtarët e saj të familjes, por praktikisht vepra penale e kryer kundër një personi është kryer në fakt kundër të gjithë shoqërisë. Çdo shoqëri funksionon bazuar në rregulla dhe ligje të shkruara dhe shkelja e tyre, nënkupton se kjo shoqëri nuk funksionon siç duhet. Kur kryhet një veprër penale shoqëria duhet të reflektojë mbi mënyrën se si po funksionon dhe të bëjë të gjitha rregullimet e nevojshme në sjellje apo legjislacion për të shmangur më vonë viktimizimin e shumëfishtë.

Një nga mënyrat se si viktima merr një rol aktiv në kryerjen e një vepre penale është nëpërmjet provokimit të autorit. Kodi Penal(KP) parashikon se *"Lehtësojnë dënimin rrethanat që vijojnë: b.kur vepra është kryer nën ndikimin e tronditjes psikike të shkaktuar nga provokimi ose veprime të padrejta të viktimës apo të ndonjë personi tjetër.*[6]*"*. Përfshirja e provokimit të viktimës është problematike po aq sa do të ishte edhe në qoftë se nuk do të parashikohej. Pavarësisht se autori i veprës penale mbetet i rrezikshëm edhe në qoftë se viktima e ka provokuar, vërtetimi se këto veprime kanë ndikuar drejtpërdrejtë tek ai është i vështirë dhe ndonjëherë abuziv. Gjykata duhet

[3] KPP përdor termin trashëgimtarë.
[4] Besa Arifi, "*Ridefinimi i rolit të viktimës në të drejtën penale bashkëkohore përmes reformave ligjore*", Konferenca Vjetore "*Roli i viktimës në të drejtën penale bashkëkohore*", Republika e Maqedonisë së Veriut 2008, faqe 2.
[5] Marvin E. Wolfgang and Simon I. Singer. "*Victim Categories of Crime."* The Journal of Criminal Law and Criminology (1973-), vol. 69, no. 3, Northwestern University School of Law, 1978, faqe 384.
[6] Ligji Nr. 7895, datë 27.01.1995 "*Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar.

të theksojë që provokimi/faktori nxitës duhet që të jetë i një natyre të mjaftueshme sa të shtyjë një person të bjerë në një gjendje "të tronditjes së fortë psikike" dhe të humbasë kontrollin.[7] Sipas Common Law, i takon prokurorisë të vërtetojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se ndaj të njëjtit provokim, një person i ndryshëm do të vepronte ndryshe.[8]

Aplikimi i kësaj rrethane duhet të varet nga vepra penale e kryer. Viktimat e krimeve seksuale janë viktima tepër delikate dhe aplikimi i një rrethane të tillë lehtësuese ndaj autorit që ka ndërmarrë këto veprime do të përbënte viktimizim të dyfishtë të saj. Interpretimi që i bëhet kësaj rrethane është abuziv pasi shpesh herë autorët e krimeve seksuale parashtrojnë para gjykatës se ishin veprimet e viktimës ato që e shtynë të ndërmarrë veprime kriminale. Sipas Bradford Bigler, provokimi nxitës në një rast përdhunimi çon në një zjarr pasioni ku mungon pëlqimi.[9] Nga interpretimi i autorit apo pjesës më të madhe të shoqërisë, konsiderohet provokim i viktimës edhe veshja e saj, mënyra se si ecën, se si flet apo edhe vendet ku ajo vendos të rrijë apo kalojë.

Vrasja me dashje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike të çastit shkaktuar nga dhuna ose fyerja e rëndë e viktimës dënohet me burgim gjer në tetë vjet[10]. Edhe pse viktima luan rol në kryerjen e veprës penale nëpërmjet dhunës ose fyerjeve të rënda të bëra autorit, masa e dënimit për këtë vepër penale është e lartë dhe konsiderohet si vrasje e kryer me dashje, pavarësisht tronditjes së momentit. Ky sanksionim është bërë në këtë mënyrë duke i kushtuar rëndësi vetkontrollit të autorit. Në qoftë se gjithësecili prej nesh do të kryente vepra penale për shkak të provokimeve dhe nuk do të dënohej prej këtij fakti, shoqëria do të gjendej në një situatë të paqëndrueshme dhe të pasigurt.

---

[7] OSBE, "*Analiza e procedimeve të çështjeve penale në Apel* në Republikën e Shqipërisë", Shtypi "albPAPER", Tiranë 2007, faqe 36.

8 Wing Cheong Chan, "*THE PRESENT AND FUTURE OF PROVOCATION AS A DEFENCE TO MURDER IN SINGAPORE*." Singapore Journal of Legal Studies, National University of Singapore (Faculty of Law), 2001, faqe. 457.

[9] Morgan Tilleman, *"(TRANS)FORMING THE PROVOCATION DEFENSE."* The Journal of Criminal Law and Criminology (1973-), vol. 100, no. 4, Northwestern University School of Law, 2010, faqe 1682.

[10] Neni 82 i KP.

Marrëdhënia autor – viktimë është e komplikuar dhe kërkon një studim të gjithanshëm për të përcaktuar shkallën e fajësisë së autorit. Viktimat e krimeve seksuale janë viktima mjaft delikate të cilat duhen trajtuar me shumë kujdes si nga institucionet dhe legjislacioni. Pjesa më e madhe e viktimave që vuajnë pasojat e krimeve seksuale janë gra dhe vajza dhe ato janë viktima vetëm se i përkasin gjinisë femërore. Autorët e krimeve seksuale në disa raste kanë lidhje intime me viktimën. Të pandehurit, që viktimizojnë partnerë intimë perceptohen si më pak fajtorë sesa të pandehurit që viktimizojnë partnerë jo-intimë sepse provokimi i viktimës në një akt të dhunshëm ul fajësinë e të pandehurit dhe rastet që përfshijnë të pandehur dhe viktima të njohura nga njëri-tjetri shpesh supozohet se përfshin ndonjë formë të provokimit të viktimës.[11] KP sanksionon mbrojtjen e viktimave të krimeve seksuale duke parashikuar rrethanat e kryerjes së këtyre krimeve dhe cilësitë e viktimës[12].

Rasti i kryerjes së një vepre penale në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshmë është rasti më i pastër i ndërrimit të roleve autor – viktimë. Mbrojtja e nevojshme nënkupton zmbrapsjen e një sulmi të padrejtë, të vërtetë dhe të çastit që i drejtohet një personi i cili ka qenë i detyruar të veprojë për të mbrojtur jetën, shëndetin,të drejtat dhe interesat e tij ose të ndonjë tjetri.[13] Deri në momentin që kundërsulmi është në përputhje me sulmin, personi përjashtohet nga përgjegjësia penale dhe veprimet e tij legjitimohen të ligjshme. KP e parashikon kapërcimin e kufijve të mbrojtjes së nevojshme në Kreun II, Neni 83. Shpesh viktima, e më pas autor, për shkak të momentit të vështirë ku gjendet dhe mungesës së të menduarit në mënyrë të qetë, tejkalon sulmin që është ndërmarrë ndaj tij. Kjo dispozitë aplikohet edhe për krimet seksuale, kur viktima e

[11] Myrna Dawson, "*Intimacy and Violence: Exploring the Role of Victim-Defendant Relationship in Criminal Law",* Volum 96, Article Nr.4, Journal of Criminal Law and Criminology, 2005-2006.

[12] Në seksionin VI të KP parashikohen krimet seksuale të kryerja ndaj të miturit/at duke e lidhur me arritjen e pjekurisë seksuale dhe me moshën. Ndërsa, lidhur me krimet seksuale me të rriturit/at legjislacioni ynë parashikon mungesën e pëlqimit dhe përdorimin e dhunës. Shiko Nenet 100 – 108/a të Kodit Penal.

[13] Neni 19 i KP.

këtyre krimeve ndërmerr një kundërsulm ndaj autorit. Në momentin e kryerjes së një marrëdhënieje seksuale me dhunë, viktima e sulmit përjeton një tronditje të fortë e cila shpesh e detyron të kryejë një kundërsulm i cili e kapërcen intensitetin e sulmit. Sipas KP, kundërveprimi i viktimës mund të cilësohet si vepër penale si nga neni që parashikon kryerjen e një vepre penale në momentin e gjendjes së tronditjes së fortë psikike edhe sipas nenit që parashikon kapërcimin e mbrojtjes së nevojshme. Për viktimat e krimeve seksuale duhet të bëhet një hetim shumë i detajuar dhe të vërtetohet se kundërsulmi ka qenë e vetmja mënyrë për t'u mbrojtur në ato momente, edhe në qoftë se janë përdorur mjete që nuk përputhen më intensitetin e sulmit. Vërtetimi i këtyre rrethanave duhet ta përjashtojë viktimën nga përgjegjësia penale, pasi gjykimi dhe dënimi si autor nuk sjell asgjë më shumë sesa viktimizimin e dyfishtë të personit. Sipas statistikave zyrtare[14], pjesa më e madhe e të dëmtuarve nga krimet seksuale i përkasin gjinisë femërore. Për shkak të mbrojtjes që këto gra dhe vajza ndërmarrin në momentin që u drejtohet një sulm, sot në burgjet e vendit, shumë prej tyre vuajnë dënimin si autore të një vepre penale edhe pse në të vërtetë ato janë viktima të saj.

KP ka parashikuar në disa dispozita të tij mbrojtjen e viktimave me aftësi të kufizuara ose viktimave të pazotë për tu mbrojtur. Neni 50 parashikon se *"e. kur vepra është kryer kundër fëmijëve, grave shtatzëna ose personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen".* Po i njëjti nen parashikon në shkronjën j kryerjen e një vepre penale të shtyrë nga aftësitë e kufizuara të personit. Të dyja këto rrethana do të konsiderohen si rrethana rënduese që do të mbahen parasysh në dhënien e dënimit të autorit të veprës penale. Kryerja e veprave penale ndaj personave të pazotë, sipas paragrafit të parë të nenit 103[15], kryhet duke përfituar nga pazotësia

[14] INSTAT, "*Statistikat vjetore të krimeve 2019*", faqe 4.
[15] Neni 103 i KP.

fizike ose mendore e viktimës. Pra, roli i viktimës në kryerjen e vepërs penale në këtë rast është mbajtja e kësaj cilësie që shtyn autorin e veprës penale të kryejë veprime kriminale ndaj saj.

Një parashikim tjetër përsa i përket personave të pazotë për tu mbrojtur lidhet me veprën penale të përndjekjes[16]. Kur përndjekja kryhet ndaj një personi të pazotë për tu mbrojtur, vepra do të konsiderohet e kryer në rrethana cilësuese dhe për të parashikohet një masë dënimi e rritur deri në një të dytën e dënimit të dhënë në qoftë se vepra do të kryhej ndaj një personi tjetër pa këto cilësi.

Gratë dhe fëmijët gëzojnë një trajtim të diferencuar nga legjislacioni ynë penal pasi konsiderohen si grupe më të ekspozuara ndaj veprave penale dhe me më pak aftësi mbrojtëse për shkak edhe të forcës së tyre fizike e cila nuk krahasohet me forcën e një burri. Arsyeja pse vepra penale drejtohet ndaj këtyre grupeve shoqërore është fakti se viktima është grua ose fëmijë dhe viktima sërisht ka një rol pasiv në kryerjen e veprës penale, nëpërmjet të cilit ajo vuan vetëm pasojat. Jetët e grave kontrollohen nga imazhet e përfshira në ideologjinë e krimit në mënyra të ndryshme dhe imazhet e viktimave ideale përforcojnë idenë e grave të dobëta, pasive dhe të paaftë për të mbrojtur veten kundër grabitqarëve mizorë, çnjerëzor dhe të çmendur që janë burra më të fortë dhe më agresivë.[17]

Mbrojtja e grave dhe fëmijëve, përveç neneve të përgjithshme ku sanksionohet mbrojtja e të gjitha viktimave, sanksionohet në shumë nene të veçanta të KP si vepër penale e pavarur apo si rrethanë rënduese e sanksionuar në paragraf të neneve të përgjithshme. Fillimisht, mbrojtja e veçantë e këtyre dy grupeve bëhet që në nenin 50[18] shkronja e në të cilin sanksionohet rrethana

---

[16] Po aty, neni 121/a.

17 Esther I. Madriz, "*Images of Criminals and Victims: A Study on Women's Fear and Social Control.*" Gender and Society, vol. 11, no. 3, Sage Publications, Inc., 1997, faqe 354.

[18] Po aty, neni 50 "e) *kur vepra është kryer kundër fëmijëve, grave shtatzëna ose personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen*;".

rënduese e kryerjes së veprës penale ndaj grave shtatzëna ose fëmijëve. Në qoftë se, autori ka kryer një vepër penale dhe viktima ka pasur një nga këto cilësi në momenit kur vepra është kryer, automatikisht përveç përgjegjësisë që autori ka i shtohet edhe kjo rrethanë rënduese e parashikuar me të drejtë nga KP. Ashtu siç trajtuam edhe me sipër, njësoj si përndjekja e personit të pazotë për tu mbrojtur, edhe përndjekja e gruas shtatzënë apo e fëmijës dënohet deri në një të dytën më shumë se dënimi i dhënë se kur përndjekja kryhet ndaj një personi që nuk i ka këto cilësi.[19] Një parashikim tjetër, tepër i rëndësishëm, është mos aplikimi i rrethanës lehtësuese[20] së normalizimit të marrëdhënieve autor – viktimë, ndaj autorit që kryen një vepër penale ndaj fëmijëve apo vepër penale të dhunës në familje. Normalizimi i këtyre marrëdhënieve mund të jetë i përkohshëm dhe kjo mund të sjellë sërisht përfshirje të autorit në vepër penale më viktimën. Përveç dispozitave të KP, të miturit viktima të veprave penale mbrohen në mënyrë të detajuar nga një kod i veçantë[21].

Po ashtu, roli i viktimave të dhunës në familje në kryerjen e një vepre penale, është pasja e marrëdhënieve të veçanta të parashikuara nga legjislacioni[22], me autorin e veprës penale. Ndonjë herë është e vështirë të përcaktohet se kush ka qenë arsyeja që kjo dhunë ka ndodhur dhe sa ka qenë roli aktiv i viktimës dhe veprimeve të saj në provokimin e dhunës. KP parashikon në mënyrë të detajuar dhunën në familje duke shtuar në paragraf të nenit 130/a edhe rrethana cilësuese në të cilat kjo dhunë ndodh. Sipas këndvështrimit tim, me gjithë parashikimin e mirë që bëjnë instrumentat ndërkombëtar dhe legjislacioni ynë penal, gjyqtarët në momentin e dhënies së vendimit të dënimit duhet të tregohen të kujdesshëm lidhur me marrëdhënien e autorit me viktimën dhe nuk duhet të ushtrojnë presion lidhur me pajtimin e palëve për shkak të

[19] Po aty neni 121/a, paragrafi 3.
[20] Po aty neni 48, shkronja e).
[21] Ligji Nr. 37/2017 "*Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur*".
[22] Për me tepër shiko nenin 130/a të Kodit Penal.

marrëdhënies së tyre. Dhuna në familje është një temë shumë delikate dhe viktimat e saj nuk luajnë asnjë rol tjetër aktiv në kryerjen e veprës penale, përveçse janë viktima të tyre. Motivet e dhunës ndaj grave brenda familjes janë të dobta dhe shpesh nuk kanë lidhje drejtëpërdrejtë me to. Dhuna ndaj grave të varfra, ndikon në aftësinë e tyre për t'u larguar nga marrëdhëniet dhe për këtë arsye ato bëhen shpesh viktima më shumë se një herë për shkak të mosraportimit pranë organeve kompetente.[23]

Përfundime dhe rekomandime

Së pari, gjithmonë kemi dy viktima të një vepre penale, viktima në aspektin e ngushtë që është ai person që vuan pasojat dhe viktima në aspektin e gjerë që është shoqëria.

Së dyti, autorët e krimeve seksuale shpesh kthehen në autorë veprash penale për shkak se mundohen të mbrohen me çdo formë apo mjet që të munden.

Së treti, viktima të ndryshme luajnë role të ndryshme në kryerjen e një vepre penale duke qenë aktiv ose pasiv në veprimet e tyre. Disa viktima janë të tilla për shkak të cilësive që ato mbartin dhe roli i tyre i vetëm në kryerjen e veprës penale është mbajtja e këtyre cilësive si p.sh aftësi të kufizuara, paaftësi për tu mbrojtur, përkatësia gjinore, etj.

Disa rekomandime të miat, në funksion të këtij punimi janë:

- Legjislacioni duhet të trajtojë në mënyrë të diferencuar autorët që kanë kryer vepra penale për shkak se kanë qenë viktima të krimeve seksuale, duke mbajtur parasysh delikatesën dhe vëmendjen e veçantë që duhet treguar gjatë trajtimit të këtyre viktimave;

[23] Demie Kurz, "*Women, Welfare, and Domestic Violence.*" Social Justice, vol. 25, no. 1 (71), Social Justice/Global Options, 1998, faqe 118.

- Autorët e veprave penale, pas rehabilitimit të tyre, duhen mbajtur në vëmendje dhe duhet bërë një studim se sa janë normalizuar marrëdhëniet autor-viktimë dhe sa i lartë është rreziku që ky autorë të kthehet në viktimë për shkak të veprës penale për të cilën ka vuajtur dënimin;

- Në nenin 107/a të Kodit Penal duhet të sanksionohet edhe dhuna seksuale midis ish/bashkëshortëve apo ish/partnerëve, duke e parë këtë si një mangësi të legjislacionit.

BIBLIOGRAFI

Legjislacion

- Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit të Pushtetit, miratuar nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 40/34 të 29 nëntorit 1985.
- Direktiva 2012/29 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 25 tetorit 2012 "*Vendosja e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit*".
- Ligji Nr.7905, datë 21.03.1995 **"***Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar
- Ligji Nr. 7895, datë 27.01.1995 "*Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 37/2017 "*Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur*".

Literaturë

- Besa Arifi, "*Ridefinimi i rolit të viktimës në të drejtën penale bashkëkohore përmes reformave ligjore*", Konferenca Vjetore "Roli i viktimës në të drejtën penale bashkëkohore", Republika e Maqedonisë së Veriut 2008.

http://ajls.org/doc/Besa%20Arifi-Viktima-ne-Drejte-Penale-AJLS-2008.pdf

- Organization for Security and Co-operation in Europe (OSBE), "*Analiza e procedimeve të çështjeve penale në Apel në Republikën e Shqipërisë*", Shtypi "*albPAPER*", Tiranë 2007.

https://www.osce.org/files/f/documents/2/9/30208.pdf

- Marvin E Wolfgang, and Simon I Singer, "*Victim Categories of Crime."* The Journal of Criminal Law and Criminology (1973-), vol. 69, no. 3, Northwestern University School of Law, 1978.

https://www.jstor.org/stable/1142333?origin=crossref&seq=1#metadata_info_tab_contents

- Wing Cheong Chan, "*THE PRESENT AND FUTURE OF PROVOCATION AS A DEFENCE TO MURDER IN SINGAPORE*." Singapore Journal of Legal Studies, National University of Singapore (Faculty of Law), 2001.

https://www.jstor.org/stable/24867808?seq=1#metadata_info_tab_contents

- Morgan Tilleman, *"(TRANS)FORMING THE PROVOCATION DEFENSE."* The Journal of Criminal Law and Criminology (1973-), vol. 100, no. 4, Northwestern University School of Law, 2010

https://www.jstor.org/stable/25766132?seq=1#metadata_info_tab_contents

- Demie Kurz, "*Women, Welfare, and Domestic Violence*." Social Justice, vol. 25, no. 1 (71), Social Justice/Global Options, 1998.

https://www.jstor.org/stable/29767061

- Esther I. Madriz, "*Images of Criminals and Victims: A Study on Women's Fear and Social Control*." Gender and Society, vol. 11, no. 3, Sage Publications, Inc., 1997.

https://www.jstor.org/stable/190406

- Dawson, "*Intimacy and Violence: Exploring the Role of Victim-Defendant Relationship in Criminal Law",* Volum 96, Article Nr.4, Journal of Criminal Law and Criminology, 2005-2006.

https://scholarlycommons.law.northwestern.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=7248&context=jclc